



LIGJ
Nr. 170/2014

PËR RATIFIKIMIN E
MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR
RIMËKËMBJEN E SEKTORIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2014

Shpallur me dekretin nr. 8871, datë 29.12.2014
të Presidentit të Republikës Bujar Nishani

Hua nr. 8429-AL

MARRËVESHJE
HUAJE NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT PËR RIMËKËMBJEN E
SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Marrëveshje e datës 3 nëntor, 2014, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

2.01 Banka bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind mijë euro (€112,100,000), ku kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet kursit të këmbimit të monedhës në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje (“Huaja”), për të asistuar financimin e projektit të përshkruar në grafikun 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas në pajtim me seksionin IV të grafikut 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi është me një normë të barabartë me Normën e Referencës për monedhën e Huas plus Marzhin Fiks; me kusht që për një këmbim të të gjithës ose një pjese të shumës principale të Huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë periudhës së këmbimit për këtë shumë të përcaktohet në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit IV të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht sa më sipër, nëse një shumë e balancës së tërhequr të Huas mbetet e papaguar kur bëhet e kërkueshme dhe kjo mospagesë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi llogaritet sipas parashikimit në seksionin 3.02(e) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesave janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.



2.06 Shuma principale e Huas shlyhet në pajtim me grafikun e amortizimit të parashikuar në pjesën e 3-të të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë një prej Konvertimeve të mëposhtme të termave të Huas, me qëllim që të lehtësohet menaxhimi i arsyeshëm i borxhit: i) një ndryshim i monedhës së huas për të gjithë ose një pjesë të shumës principale të Huas, të tërhequr ose të patërhequr, në një monedhë të aprovuar; ii) një ndryshim të bazës së normës së interesit të zbatueshme për: A) të gjithë ose një pjesë të shumës principale të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një normë e ndryshueshme të një normë fikse, ose anasjelltas; ose B) të gjithë ose një pjesë të shumës principale të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një normë e ndryshueshme e bazuar në një normë reference dhe marzhi i ndryshueshëm të një normë e ndryshueshme bazuar në një normë reference fikse dhe marzhin e ndryshueshëm, ose anasjelltas; ose C) të gjithë shumën principale të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një normë e ndryshueshme bazuar në një marzh të ndryshueshëm të një normë e ndryshueshme bazuar në një marzh fikse; dhe iii) caktimin e kufijve për një normë të ndryshueshme ose normën e referencës të zbatueshme për të gjithë ose një pjesë të shumës principale të Huas së tërhequr dhe të pakthyer nga vendosja e një kufiri maksimal të normës së interesit ose game të normës së interesit me një normë të ndryshueshme ose normë reference.

b) Çdo këmbim i kërkuar sipas paragrafit “a” të këtij seksioni që pranohet nga Banka konsiderohet “Këmbim”, sipas përkufizimit në kushtet e përgjithshme, dhe realizohet në pajtim me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme dhe të udhëzimeve për këmbimin.

Neni 3

Projekti

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të zbatojë pjesën 4 të Projektit nëpërmjet MEI-t dhe merr masa që pjesa 1 e Projektit të zbatohet nga KESH-i, pjesa 2 e Projektit të zbatohet nga OSHEE-ja dhe pjesa 3 e Projektit të zbatohet nga OST-ja (së bashku,

“Subjektet e zbatimit të projektit” në pajtim me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjeve përkatëse të Projektit.

3.02. Pa kufizuar dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi garanton që Projekti të zbatohet në pajtim me dispozitat e grafikut 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Mjetet mbrojtëse të bankës

4.01 Rastet shtesë të pezullimit konsistojnë në sa vijojnë, në rastet kur legjislacioni i një prej subjekteve zbatuese të Projektit është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose hequr dorë, duke ndikuar kështu në mënyrë të konsiderueshme dhe të pafavorshme tek aftësia e subjektit përkatës zbatues të Projektit për të përmbushur një prej detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes përkatëse të Projektit.

4.02 Rastet shtesë të përshpejtimit konsistojnë në sa vijojnë, veçanërisht të specifikuara në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Hyrja në fuqi; zgjidhja

5.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen sa më poshtë:

a) Huamarrësi nëpërmjet MEI-t ka përgatitur dhe miratuar një Manual të Funksionimit të Projektit të pranueshëm për Bankën.

b) Huamarrësi nëpërmjet MEI-t ka: i) ngritur një NJMP-në (PMU) dhe ka marrë masa që Subjektet e Zbatimit të Projektit të kenë ngritur NJZP-të (PIU); dhe ii) rekrutuar për NJMP-në dhe ka marrë masa që Subjektet e Zbatimit të Projektit të kenë rekrutuar për NJZP-të personel me kualifikimet, eksperiencën dhe përvojën e pranueshme për Bankën.

c) Marrëveshjet Dytësore të Huas janë nënshkruar në emër të Huamarrësit me subjektet zbatuese të Projektit.

5.02 Çështja ligjore shtesë konsiston në sa vijon, përkatësisht, marrëveshjet dytësore janë autorizuar dhe ratifikuar rregullisht nga Huamarrësi dhe çdo subjekt përkatës zbatues i Projektit dhe çdo Marrëveshje dytësore është ligjërisht detyruese për Huamarrësin dhe çdo subjekt përkatës zbatues të Projektit në pajtim me kushtet e saj.



5.03 Afati i hyrjes në fuqi është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Përfaqësuesit; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.

6.02 Adresa e Huamarrësit është: Ministria e Financave nr. 3, bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Tiranë, Shqipëri; faks: 355 42228494

6.03 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W. Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa kabllore

: Teleks: Faks:

INTBAFRAD 248423(MCI) ose 1-202-477-6391

Washington, D.C. 64145 (MCI)

Rënë dakord në Tiranë, Republika e Shqipërisë, në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësues i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Përfaqësues i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

PJESA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTT

Objektivi i Projektit është përmirësimi i besueshmërisë së furnizimit dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit të energjetikës.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Mbështetje plotësuese afatshkurtër për importin e energjisë

Dhënia e mbështetjes për Huamarrësin për blerjen e importeve plotësuese afatshkurtra të energjisë për të plotësuar diferencat e energjisë që rrjedhin nga kapaciteti i ulur i gjenerimit të

energjisë nga KESH-i si rezultat i punimeve rehabilituese të turbinave.

Pjesa 2. Përmirësimi i Infrastrukturës së Shpërndarjes

Asistencë për Huamarrësin që të ulë humbjet e energjisë, përmirësojë arkëtimeve dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji nëpërmjet:

a) furnizimit dhe instalimit të transformatorëve dhe pajisjeve ndihmëse të nënstacionet e përzgjedhura në Tiranë;

b) kryerjes së investimeve të synuara në rrjetin e tensionit të mesëm, duke përfshirë linjat kabllore, shtyllat e betonit, çelësat e fuqisë në bokse metalike, kabinat e shpërndarjes së energjisë dhe pajisjet përkatëse të matjes;

c) furnizimit dhe instalimit të matësve të energjisë për klientët të cilët kanë matës të dëmtuar ose nuk kanë; dhe

d) përmirësimit të sistemeve të faturimit dhe arkëtimit dhe duke kryer trajnimet e nevojshme për zbatimin e tij.

Pjesa 3. Përmirësimi i Qendrës së të Dhënave të Matjes së Transmetimit/Fuqizimi i kapacitetit të OST-së për të transmetuar energji, duke përfshirë:

a) ofrimin e matësve të energjisë dhe përmirësimin e qendrës së të dhënave; dhe

b) furnizimin dhe instalimin e sistemit të teknologjisë së informacionit për qendrën e të dhënave të OST-së dhe dhënien e asistencës teknike për zhvillimin e procedurave për ngritjen e një platforme tregu, për prodhuesit e pavarur të energjisë dhe klientët e përshtatshëm ndërmjet të tjerash.

Pjesa 4. Mbështetja e reformave në Sektorin e Energjisë dhe Zbatimit të Projektit

a) Kryerja e reformave prioritare në sektorit të energjisë për të lehtësuar rimëkëmbjen e sektorit energjetik dhe përmirësuar menaxhimin e shoqërisë së shpërndarjes, nëpërmjet dhënies së shërbimeve këshillimore teknike për:

i) rishikimin e modelit të tregut të energjisë për të prezantuar më shumë konkurrencë në sektor dhe ulur detyrimin e Huamarrësit për furnizim me energji sipas direktivave përkatëse të BE-së;

ii) rishikimin e ligjit të energjisë së rinovueshme për të siguruar qëndrueshmërinë e prodhuesve të pavarur të energjisë;



iii) prezantimin e një metodologjie të re të tarifave për të reflektuar përditësimet në modelin e tregut të energjisë;

iv) përditësimin e strategjisë aktuale të energjisë të Huamarrësit; dhe

v) Hartimi i programeve të zbatimit dhe mbikëqyrjes të mbështetjes sociale që synon konsumatorët e energjisë dhe aktorët kryesorë.

b) Mbështetja e një njësie për menaxhimin e Projektit pranë MEI-t nëpërmjet dhënies së mallrave, kostove operative, trajnimit dhe shërbimeve këshillimore teknike.

c) Ofrimin e shërbimeve të specializuara këshilluese për të mbështetur zbatimin dhe monitorimin e Programit të Menaxhimit të Performancës së OSHEE-së.

d) Kryerja e një studimi të menaxhimit të riskut për të zbutur ndikimin e paqëndrueshmërisë së motit në sektorin e energjisë.

PJESA 2 ZBATIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I: Masat abatuuese

A. Masat institucionale

1. Njësia e Menaxhimit të Projektit

Huamarrësi nëpërmjet MEI-t, do të krijojë dhe të mbajë, gjatë gjithë zbatimit të Projektit, një Njësi të Menaxhimit të Projektit, e cila menaxhohet nga një Koordinator Projekti i emëruar nga MEI- me personel kryesor që ka funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, duke përfshirë përgjegjësitë e mëposhtme: a) përgatit Manualin e Funksionimit të Projektit, së bashku me NJZP-të, që aprovohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë; b) ndihmon NJZP-të në zhvillimin e dokumenteve të tenderit; c) ndihmon Huamarrësin, nëpërmjet MEI-t, për ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave që përbëhen nga personel i NJMP-se dhe NJZP-së, sipas rastit, në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit (MFP); d) duke mbështetur koordinimin bashkërendimin në hartimin dhe monitorimin e programeve të mbështetjes sociale; e) kryen mbikëqyrjen e zbatimit, duke përfshirë mbikëqyrjen, sipas rastit; dhe f) kryen monitorime periodike dhe

vlerësimin e zbatimit të Projektit.

2. Njësitë e Zbatimit të Projektit

a) Huamarrësi, nëpërmjet MEI-t, do të detyrojë subjektet e zbatimit të Projektit të krijojnë dhe të mbajnë gjatë gjithë zbatimit të Projektit, NJZP-të me personelin kryesor, duke përfshirë koordinatorët, specialistët e prokurimeve, specialistët e menaxhimit financiar dhe specialistë të tjerë teknikë me funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën.

b) NJZP-të do të mblidhen të paktën dy herë në vit dhe do të jenë përgjegjëse për zbatimin e përditshëm të pjesëve përkatëse të Projektit të subjekteve të zbatimit të Projektit, duke përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e buxheteve përkatëse të NJMP-ja për trajtim.

B. Masat e zbatimit

1. Manuali i Funksionimit të Projektit

Pa u kufizuar të dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme, Huamarrësi, do të garantojë nëpërmjet MEI-së, që:

a) Projekti është zbatuar në pajtim me Manualin e Funksionimit të Projektit; dhe

b) Manuali i Funksionimit të Projektit ose ndonjë pjesë e tij të mos ndryshohet, hiqet dorë, pezullohet ose shfuqizohet pa pëlqimin paraprak të Bankës me shkrim dhe në çdo rast të mospërputhjes ndërmjet dispozitave të Manualit të Funksionimit të Projektit dhe të kësaj Marrëveshjeje, do të kenë përparësi dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Marrëveshjet Dytësore të Huas

a) Për të lehtësuar zbatimin e pjesëve përkatëse të projektit për subjektet e zbatimit të Projektit, Huamarrësi i jep hua KESH-it shumat e Huas së përcaktuar për pjesën e 1-rë të Projektit, OSHEE-së shumat e Huas të përcaktuara në pjesën e 2-të të Projektit dhe OST-së shumat e Huas të përcaktuara në pjesën e 3-të të Projektit sipas marrëveshjeve dytësore ("Marrëveshje dytësore të Huas") ndërmjet Huamarrësit dhe çdo subjekti të zbatimit të Projektit, sipas termave dhe kushteve të miratuara nga Banka, duke përfshirë sa më poshtë:

i) shumat e Marrëveshjeve dytësore të Huas do të jenë përcaktuara dhe të pagueshme në lekë;

ii) Huamarrësi do të vendosi interes mbi shumën e principalit të tërhequr dhe të pashlyer herë pas here me një normë prej tre të katërtat e



një përqindëshit (0/75 %) në vit; dhe

iii) Huat dytësore do të jenë të pagueshme brenda një periudhe kohore që nuk i kalon 22.5 vjet nga data e Marrëveshjes dytësore të Huas, duke përfshirë një periudhë pa interes që nuk i tejkalon 7 vite.

iv) OSHEE-ja do të kontribuojë me 10% të vlerës së kontratës sipas kategorisë 2 dhe OST-ja me 20% të vlerës së kontratës sipas kategorisë 3 përkatësisht siç përcaktohet në tabelën në seksionin V të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje; dhe garanton që të gjitha kontratat janë prokuruar në përputhje me udhëzimet përkatëse të prokurimit të Bankës Botërore.

b) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij sipas çdo Marrëveshjeje dytësore të Huas, në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe Bankës dhe të përmbushë qëllimet e Huas. Përveç kur Banka do të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi nuk do të transferojë, ndryshojë, shfuqizojë apo heqë dorë nga asnjë Marrëveshje Dytësore e Huasë dhe nga asnjë dispozitë e saj.

3. Kontratat e Shërbimit të Energjisë (KSHE-të)

a) Në zbatimin e pjesës 4(a) të Projektit, Huamarrësi do të garantojë, jo më vonë se data 31 tetor 2014, që Subjektet e Zbatimit të Projektit të lidhin marrëveshjet (“Kontratat e Shërbimit të Energjisë”) të kënaqshme për Bankën, të cilat përbëhen nga:

i) KSHE-ja ndërmjet KESH-it dhe OSHEE-së (“KSHE-ja KESH/OSHEE”) që përcakton detyrimin e OSHEE-së për të blerë energjinë e gjeneruar nga KESH-i;

ii) KSHE-ja ndërmjet KESH-it dhe OST-së (“KSHE-ja KESH/OST”) që përcakton detyrimin e OST-së për të transmetuar energjinë e gjeneruar nga KESH-i; dhe

iii) KSHE-ja ndërmjet OSHEE-së dhe OST-së (“KSHE-ja OSHEE /OST”) që përcakton detyrimet e OST-së për të transmetuar energjinë e blerë nga OSHEE-ja.

b) Huamarrësi siguron që KSHE-ja të përmbajë informacion mbi: i) grafikët ditorë, shmangiet dhe llogaritë; ii) gjendjen mujore të energjisë; iii) energjinë mujore dhe shlyerjen financiare bazuar në metodologjinë e monitoruar dhe të vendosur nga

operatori i tregut dhe OST-ja; dhe iv) pagesat mujore dhe garancitë nëpërmjet bankave tregtare.

c) Huamarrësi do të sigurojë që kontratat e shërbimit të energjisë të mos transferohen, ndryshohen, shfuqizohen ose të hiqet dorë pa aprovimin paraprak me shkrim të Bankës.

C. Antikorrupsioni

Huamarrësi do të garantojë që Projekti është kryer në përputhje me dispozitat e udhëzimeve antikorrupsion.

D. Masat mbrojtëse

1. Në zbatimin e pjesëve 2 dhe 3 të Projektit, Huamarrësi do të marrë masa që OSHEE-ja të OST-ja të garantojnë që pjesët e tyre përkatëse të Projektit të zbatohen në përputhje me Kuadrin e Masave Mbrojtëse dhe Instrumentet e Masave Mbrojtëse. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të marrë masa që OSHEE-ja dhe OST-ja të ndërmarren veprimet e mëposhtme në një mënyrë të pranueshme për Bankën:

a) nëse ndonjë aktivitet i Projektit, në vijim të Kuadrin Menaxherial-Mjedisor dhe Social (“KMMS”):

i) kërkon kryerjen e një Vlerësimi të Ndikimit Mjedisor dhe Social (“VNMS”): A) kryerjen e një VNMS-je në pajtim me kërkesat e KMMS-së dhe ia paraqet këtë VNMS Bankës për rishikim dhe aprovim; dhe B) e deklaron VNMS-n, siç kërkohet nga KMMS-ja dhe aprovohet nga Banka; dhe

ii) kërkon përgatitjen e një Plani të Ndikimit Mjedisor dhe Social (“PNMS”): A) përgatit një PNMS në përputhje me kërkesat e KMMS-së dhe ia paraqet këtë KMMS Bankës për rishikim dhe aprovim; dhe B) e deklaron KMMS-në, siç kërkohet nga KMMS-ja dhe aprovohet nga Banka; dhe

b) nëse kërkohet një Plan Veprimi Risistemimi (“PVR”) për një aktivitet të caktuar të Projektit sipas pjesëve përkatëse të OSHEE-së ose OST-së të Projektit, mbi bazën e Kuadrin të Politikës së Risistemimit (“KPR”);

i) e përgatit këtë PVR në përputhje me kërkesat e KPR-së, e publikon dhe ia paraqet Bankës për rishikim dhe aprovim; dhe

ii) garanton që asnjë aktivitet në të cilin përvetësimi i tokës që përfshin risistemimin e ndonjë personi, do të fillojë, derisa të jenë marrë të gjitha masat sipas PVR-së para fillimit të këtij aktiviteti.

Seksioni II : Monitorimi, raportimi dhe



vlerësimi i projektit

A. Raportet e Projektit

Huamarrësi do të monitorojë dhe vlerësojë përparimin e Projektit dhe përgatit Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën. Çdo raport Projekti do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe i paraqitet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe kontrollat financiare

1. Huamarrësi do të mbajë ose do të marrë masa për mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Bankës jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik raportet financiare paraprake të pakontrolluara për Projektin që mbulojnë semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

3. Huamarrësi duhet të ketë pasqyrat financiare të tij të kontrolluara në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09(b) të kushteve të përgjithshme. Çdo kontroll financiar i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit, që fillon me vitin financiar në të cilin është bërë tërheqja e parë. Pasqyrat financiare të kontrolluara për çdo periudhë të tillë duhet t'i paraqiten Bankës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

Seksioni III: Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat dhe shërbimet jokonsulente. Të gjithë mallrat dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për Projektin dhe që financohen nga fondet e Huas duhet të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve të prokurimit dhe dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet konsulente të kërkuara për Projektin dhe që financohen nga fondet e Huas duhet të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentëve dhe

dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e rishikimit nga Banka të kontratave të veçanta, i referohen metodës së përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentit, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve jokonsulent

1. Tenderi/ofertimi konkurrues ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe shërbimet jokonsulente duhet të prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve jokonsulentëve. Metodot e mëposhtme, të ndryshme nga ofertimi konkurrues ndërkombëtar, mund të përdoren për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente për ato kontrata që specifikohen në Planin e Prokurimit: a) Ofertimi konkurrues kombëtar; b) Blerjet; c) Kontraktimi i drejtpërdrejtë; dhe d) prokurimi i mallrave të përdorimit, sipas procedurave të përcaktuara në paragrafin 2.68 të udhëzimeve të prokurimit.

3. Ndryshimet në procedurat ofertuese konkurruese kombëtare të Huamarrësit. Procedurat ofertuese konkurruese kombëtare ("OKK-ja") duhet të bazohet në procedurat e hapura të tenderimit siç përcaktohet në ligjin e prokurimit publik ("LPP") të Shqipërisë (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që kjo procedurë t'u nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve të prokurimit dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

a) Procedurat e "Tenderit të hapur" sipas përcaktimit të LPP-së të Shqipërisë do të zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

b) Ofertuesit e huaj nuk duhet të përjashtohen nga ofertimi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk u jepet ofertuesve vendas në procesin e ofertimit. Ndërmarrjet në pronësi të qeverisë në Shqipëri lejohen të ofertojnë vetëm nëse janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Huamarrësit. Regjistrimi nuk duhet të përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;



c) Ofertat duhet të hapen në publik në një vend, menjëherë pas afatit përfundimtar për dorëzimin e ofertave në prani të përfaqësuesve të atyre që vendosin të marrin pjesë;

d) Subjektet prokuruese përdorin dokumente ofertuese model të aprovuara nga Banka.

e) Në rastin e çmimeve më të larta të ofertës sipas vlerësimit zyrtar, të gjitha ofertat nuk duhet të refuzohen pa pëlqimin paraprak të Bankës;

f) Procedura me një zarf të vetëm do të përdoret për paraqitjen e ofertave;

g) Paskualifikimi duhet të zhvillohet vetëm për ofertuesin e vlerësuar me ofertën më të ulët; asnjë ofertë nuk duhet të refuzohet në momentin e hapjes së ofertës në bazë të kualifikimit;

h) Ofertuesit në formën e një bashkimi të përkohshëm të përbashkët duhet të jenë përgjegjës të gjithë së bashku dhe veçmas;

i) Përpara refuzimit të të gjitha ofertave dhe kërimit të ofertave të reja, duhet të merret pëlqimi paraprak i Bankës;

j) Kontratat duhet t'i jepen ofertuesit të vlerësuar me ofertën më të ulët, i cili është përcaktuar të jetë i kualifikuar të veprorë, në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe të parashpallura të vlerësimit;

k) Negociatat e pas ofertimit nuk duhet të lejohen me ofertuesin e vlerësuar me vlerën më të ulët dhe as me ofertues të tjerë;

l) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më shumë se 18 muaj) duhet të përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimit.

m) Garancitë e ofertës dhe kontratës duhet të jenë në formën e përfshirë në dokumentet e ofertimit. Garancia e ofertës duhet të jetë e vlefshme për njëzet e tetë (28) ditë pas periudhës fillestare të vlefshmërisë të ofertës ose pas çdo periudhe të shtyrjes, nëse kërkohet. Asnjë pagesë paradhënieje nuk duhet të kryhet pa një garanci të përshtatshme paradhënieje;

n) Dokumentet e ofertimit dhe kontratat që konsiderohen të pranueshme nga Banka duhet të përfshijnë dispozita që përcaktojnë politikën e Bankës për të sanksionuar firmat ose individët që konstatohen të përfshirë në mashtrim dhe korrupsion sipas përcaktimeve të udhëzimeve të prokurimit;

o) Në përputhje me udhëzimet e prokurimit, çdo dokument ofertimi dhe kontratë e financuar nga shumat e Huas duhet të parashikojë që

ofertuesit, furnitorët dhe kontraktorët dhe nënkontraktorët, agjentët, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve ose furnitorët e tyre duhet të lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha llogaritë, regjistrat dhe dokumentet e tjera në lidhje me paraqitjen e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe të kontrollohen nga kontrolluese financiare të caktuar nga Banka. Veprimet që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e së drejtës së Bankës për inspektim dhe kontroll financiar të parashikuar në udhëzimet e prokurimit përbëjnë një praktikë penguese sipas përkufizimeve në udhëzimet e prokurimit.

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve duhet të prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e Përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe kosto.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Metodat e mëposhtme, të ndryshme nga përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që specifikohen në planin e prokurimit: a) Përzgjedhja e bazuar në kosto; b) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; c) Përzgjedhja nga një burim i vetëm i firmave konsulente; d) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve të konsulentëve për përzgjedhjen e konsulentëve individualë; dhe e) procedurat nga një burim i vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

D. Rishikimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit përcakton ato kontrata që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues të Bankës.

Seksioni IV: Angazhime të tjera

A. Llogaria e të ardhurave e bllokuar për garanci

1. Huamarrësi do të:

a) jo më vonë se data 31 dhjetor 2014, të marrë masat që OSHEE-ja të hapë një llogari bankare për të ardhurat e bllokuara për garanci (Escrow) në një institucion financiar të pranueshëm për Bankën dhe të depozitojë të ardhurat për të paguar



shpenzimet e transmetimit dhe blerjes së energjisë në përputhje me grafikun e mëposhtëm:

i) për secilin prej dymbëdhjetë (12) muajve të parë, i paguan KESH-it 85% të faturës së blerjes së energjisë mujore dhe OST-së 85% të faturave mujore të tarifave të transmetimit.

ii) për secilin prej njëzet e katër (24) muajve të ardhshëm, i paguan KESH-it 95% të faturës së blerjes së energjisë mujore dhe OST-së 95% të faturave mujore të tarifave të transmetimit.

iii) për secilin prej tridhjetë e gjashtë (36) muajve të ardhshëm, i paguan KESH-it 100% të faturës së blerjes së energjisë mujore dhe OST-së 100% të faturave mujore të tarifave të transmetimit.

iv) pas kësaj, i paguan KESH-it 105% të faturës së blerjes së energjisë mujore dhe OST-së 105% të faturave mujore të tarifave të transmetimit, për aq kohë sa të jenë amortizuar tërësisht prapambetjet në të ardhura të çdo subjekti të zbatimit të projektit’.

b) siguron që çdo fond i mbetur i OSHEE-së pasi është paguar KESH-i dhe OST-ja t’i transferohen OSHEE-së me bazë mujore, dhe

c) merr masa që OSHEE-ja t’ia nënshtrojë llogarinë Escrow një kontrolli financiar vjetor të pranueshëm për Bankën.

B. Raporti i borxheve me kapitalin e vet

1. Përveç kur Banka duhet të jetë dakord ndryshe, Huamarrësi duhet të garantojë që OST-ja dhe KESH-i nuk marrin asnjë borxh nëse, pas marrjes së këtij borxhi, raporti i borxhit me kapitalin e vet është më i lartë se gjashtëdhjetë (60) me dyzet (40).

2. Për qëllimet e këtij seksioni:

a) Termi “borxh” është qenia në borxh e KESH-it ose OST-së që maturohet sipas termave të tij më shumë se një vit pas datës në të cilën merret fillimisht.

b) Borxhi do të konsiderohet i marrë: i) sipas një kontrate ose marrëveshjeje huaje ose një instrumenti tjetër që parashikon këtë borxh ose për modifikimin e termave të tij të pagesës në datën e kësaj kontrate, marrëveshjeje ose instrumenti; dhe ii) sipas një kontrate garancie, në datën që është lidhur marrëveshja që parashikon këtë garanci.

c) Termi “kapital i vet” është shuma e kapitalit të përgjithshëm i paguar i pacenuar, të ardhurat e mbajtura dhe rezervat e OST-së ose KESH-it që

nuk alokohen për të mbuluar detyrime të caktuara.

d) Kurdoherë që për qëllimet e këtij seksioni duhet të jetë e nevojshme të vlerësohet, në termat e monedhës së Huamarrësit, një borxh i pagueshëm në një monedhë tjetër, ky vlerësim duhet të kryhet mbi bazën e normës mbizotëruese të ligjshme të këmbimit që është kjo monedhë tjetër, në momentin e këtij vlerësimi, e cila merret për qëllimin e shërbimit të borxhit dhe në mungesë të kësaj norme, mbi bazën e një norme të shkëmbimit të pranueshme për Bankën.

C. Mbulimi i shërbimit të borxhit

1. Përveçse kur Banka do të jetë dakord me shkrim, Huamarrësi merr të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar:

a) që OST-ja dhe KESH-i nuk do të marrin asnjë borxh, përveçse kur një parashikim i arsyeshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të OST-së dhe KESH-it tregon që të ardhurat neto të vlerësuara të OST-së dhe KESH-it për çdo vit financiar gjatë afatit të borxhit që do të merret është të paktën një (1.0) për tridhjetë e gjashtë (36) muajt e parë dhe pas kësaj një pikë gjashtë (1.6) herë kërkesat e parashikuara të shërbimit të borxhit të subjektit të zbatimit të projektit në këtë vit mbi të gjitha borxhet e OST-së dhe KESH-it, duke përfshirë borxhin e marrë;

b) që një parashikim i arsyeshëm i të ardhurave neto dhe shpenzimeve të OSHEE-së tregon se raporti i të ardhurave të parashikuara neto me kërkesat e shërbimit të borxhit është si më poshtë:

i) brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve nga data e hyrjes në fuqi, gjashtë të dhjetat (0.6);

ii) brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve pasues, një (1.0); dhe

iii) pas kësaj një e gjashtë të dhjetat (1.6).

2. Për qëllimet e këtij seksioni:

a) Termi “borxh” është qenia në borxh e subjektit të zbatimit të Projektit që maturohet sipas termave të tij më shumë se një vit pas datës në të cilën merret fillimisht.

b) Borxhi do të konsiderohet i marrë: i) sipas një kontrate ose marrëveshjeje huaje ose një instrumenti tjetër që parashikon këtë borxh ose për ndryshimin e termave të tij të pagesës në datën e kësaj kontrate, marrëveshjeje ose instrumenti; dhe ii) sipas një kontrate garancie,



në datën kur është lidhur marrëveshja që parashikon këtë garanci.

c) Termi “të ardhura neto” është diferenca ndërmjet:

i) shumës së të ardhurave nga të gjitha burimet në lidhje me operacionet dhe të ardhurat neto jooperative; dhe

ii) shumës së të gjitha shpenzimeve në lidhje me operacionet, duke përfshirë administratën, mirëmbajtjen e duhur, tatimet dhe pagesat në vend të tatimeve, por duke përjashtuar parashikimin e amortizimit, detyrimet e tjera operative jomonetare dhe interesin dhe detyrimet e tjera mbi borxhin.

d) Termi “të ardhura neto jooperative” është diferenca ndërmjet:

i) të ardhurave nga të gjitha burimet të ndryshme nga ato që lidhen me operacionet, dhe

ii) shpenzimeve, duke përfshirë tatimet dhe pagesat në vend të tatimeve, që shkaktohen nga gjenerimi i të ardhurave në pikën “i” më sipër.

e) Termi “kërkesa të shërbimit të borxhit” është shuma e përgjithshme e shlyerjeve (duke përfshirë uljen e pagesave të fondeve, sipas rastit), dhe interesin dhe detyrimet e tjera mbi borxhin.

f) Termi “parashikim i arsyeshëm” është një parashikim i përgatitur nga Subjekti përkatës i Zbatimit të Projektit jo më parë se dymbëdhjetë muaj para marrjes së borxhit në fjalë, të cilin Banka dhe Huamarrësi e pranon si të arsyeshëm dhe për të cilin Banka ka njoftuar Huamarrësin për pranueshmërinë e tij, me kusht që të mos ketë ndodhur asnjë ngjarje që nga ky njoftim, e cila ka ose mund të pritet normalisht që në të ardhmen të ketë një ndikim material negativ mbi gjendjen financiare ose rezultatet operationale të ardhshme për subjektin e zbatimit të Projektit.

g) Kurdoherë që për qëllimet e këtij seksioni të jetë e nevojshme të vlerësohet, në termat e monedhës së Huamarrësit, një borxh i pagueshëm në një monedhë tjetër, ky vlerësim do të kryhet mbi bazën e normës mbizotëruese të ligjshme të këmbimit që është kjo monedhë tjetër, në momentin e këtij vlerësimi, që merret për qëllimin e shërbimit të borxhit, dhe në mungesë të kësaj norme, mbi bazën e një norme të shkëmbimit të pranueshme për Bankën.

D. Planet e biznesit

Huamarrësi do të marrë masa që çdo subjekt i

zbatimit të projektit të përgatisë dhe paraqesë Bankës dhe Huamarrësit jo më vonë se data 31 dhjetor i çdo viti, një plan biznesi pesëvjeçar, duke përfshirë llogaritjet përkatëse financiare, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

E. Plani i rikuperimit financiar të sektorit të energjisë

1. Huamarrësi do të, jo më vonë se data 30 tetor 2014 dorëzojë Bankës një plan rikuperimi financiar të sektorit të energjisë, të pranueshëm për Bankën dhe që përfshin, pa u kufizuar, burimet e financimit për: a) importet e energjisë që nuk financohen nga Projekti; b) subvencionet e shitjes me pakicë të energjisë; c) pagesat e bëra prodhuesve privatë; dhe d) deficitet financiare të parashikuara në sektorin e energjetikës.

2. Përveç kur Banka do të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi nuk do të transferojë, ndryshojë, shfuqizojë apo heqë dorë nga plani i rikuperimit financiar të sektorit të energjisë dhe nga asnjë dispozitë e tij.

F. Detyrimet dhe ristrukturimi i shërbimit të borxhit të OSHEE-së

Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar përmbushjen e detyrimeve për shërbimin e borxhit të OSHEE-së dhe do të informojë dhe konsultohet me Bankën për çdo ristrukturim të propozuar të OSHEE-së dhe pas kësaj do të kryejë vetëm atë ristrukturim që është rënë dakord me shkrim me Bankën.

Seksioni V: Tërheqja e shumave të huas

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë shuma të Huas në pajtim me dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme të këtij seksioni dhe udhëzimeve shtesë që Banka mund të specifikojë me njoftim drejtuar Huamarrësit (duke përfshirë “Udhëzimet e lëvrimit të Bankës Botërore për projektet” të muajit maj 2006, të rishikuar herë pas here nga Banka dhe që bëhet e zbatueshme për këtë

Marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e përshtatshme që parashikohen në tabelë, në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga shumat e Huas (“Kategoria”), alokimet e shumave të Huas për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që financohen për



shpenzimet e përshtatshme në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen (përfshijë tatimet)
1. Blerjet afatshkurtra të energjisë sipas pjesës 1 të Projektit	22,419,750	100%
2. Mallrat, shërbimet e jokonsulentëve dhe trajnimet sipas pjesës 2 të Projektit	69,500,000	90%
3. Mallrat, shërbimet e jokonsulentëve dhe trajnimet sipas pjesës 3 të Projektit	14,950,000	80%
4. Mallrat, shërbimet e konsulentëve, shërbimet e jokonsulentëve, dhe shpenzimet operative sipas pjesës 4 të Projektit 4 të Projektit	4,950,000	100%
5. Tarifa fillestare	280,250	Shuma e pagueshme në pajtim me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me seksionin 2.07(b) të kushteve të përgjithshme
SHUMA TOTALE	112,100,000	



B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e bëra para kësaj date, përveç kur tërheqjet deri në një shumë të përgjithshme që nuk kalon ekuivalentin e 100,000 euro që mund të bëhet për pagesat e bëra para kësaj date por në ose pas datës 20 shtator 2013 për shpenzimet e përshtatshme sipas kategorisë 4.

2. Data e mbylljes është 30 nëntor 2019.

PJESA 3

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas që paguhet për çdo datë të pagesës së principalit (“Pjesa e këstit”). Nëse shumat e Huas janë tërhequr plotësisht brenda datës së parë të pagesës së principalit, shumat principale të Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) Balancën e tërhequr të huas të datës së parë të pagesës së principalit; me b) Pjesën e këstit për çdo datë të pagesës së principalit, ku kjo shumë e shlyeshme përshtatet, sipas rastit, për të zbritur çdo shumë që përmendet në paragrafin 4 të kësaj pjese, ku zbatohet një konvertim monedhe.

Data e pagesës së principalit	Pjesa e këstit (shprehur si përqindje)
Në çdo 15 nëntor dhe 15 maj Duke filluar nga data 15 nëntor 2021 deri dhe duke përfshirë datën 15 maj 2036.	3.23%
Më 15 nëntor 2036	3.1%

2. Nëse shumat e Huas nuk janë tërhequr plotësisht brenda datës së parë të pagesës së principalit, shumat principale të Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit përcaktohet si më poshtë:

a) Në masën që një shumë e Huas është tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit, Huamarrësi shlyen balancën e tërhequr të Huas deri në këtë datë në pajtim me paragrafin 1 të kësaj pjese;

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së principalit do të shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat e përcaktuara nga Banka duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numëruesi i së cilës është pjesa fillestare e këstit në tabelën e paragrafit 1 të kësaj pjese për këtë datë të pagesës së principalit (“Pjesa e këstit fillestar”) dhe emëruesi i të cilës është shumë e të gjithë pjesëve të mbetura të këstit fillestar për datat e pagesës së principalit që bien në ose pas kësaj date (ku këto shumë të shlyeshme duhet të përshtaten, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të kësaj pjese për të cilin zbatohet konvertimi i monedhës.

3. a) Shumat e Huas të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para çdo date të pagesës së principalit, vetëm për qëllimet e llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, të trajtuar si të tërhequr dhe të pashlyer në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes dhe do të jetë e shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që fillon në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit “a” të këtij paragrafi, nëse në një moment të caktuar



Banka miraton një sistem faturimi me datë të kërkueshme sipas së cilit faturat lëshohen në ose pas datës përkatëse të pagesës së principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk vazhdojnë të zbatohen për asnjë tërheqje të kryer pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të nënparagrafëve 1 dhe 2 të kësaj pjese, në momentin e konvertimit të monedhës së të gjithë ose një pjese të balancës së Huas së tërhequr në një monedhë të miratuar, shuma e konvertuar në monedhën e aprovuar që është e shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që ndodh gjatë periudhës së konvertimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të përcaktimit menjëherë para konvertimit me: i) normën e këmbimit që reflekton shumën e principalit në monedhën e aprovuar nga Banka sipas transaksionit të sigurimit të monedhës në lidhje me konvertimin; ose ii) nëse Banka vendos në këtë mënyrë në pajtim me udhëzimet e konvertimit, komponentin e normës së këmbimit të afishuar.

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. “Udhëzime antikorrupsion” janë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga Huat e IBRD-së, si dhe kredive dhe granteve të IDA-s”, të datës 15 tetor 2006, dhe të rishikuar në janar 2011.

2. “Komisionet e vlerësimit të ofertës” janë komisionet që ngrihen nga Huamarrësi në konsultim me MEI-në që përbëhen nga anëtarët e NJMP-së dhe NJZP-ve për të vlerësuar dokumentet e ofertimit të Projektit dhe që përmenden në seksionin I.A.1(c) të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Kategori” është një kategori e përcaktuar në tabelën e seksionit IV të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

4. “CEZ Shpërndarje” ose “CEZ” është shoqëria e shpërndarjes së energjisë e themeluar dhe e regjistruar në bazë të ligjit për themelimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të datës 8 qershor 2007, ose pasuesi i saj ligjor.

5. “Udhëzime të konsulentit” do të thotë “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore” të janar 2011 dhe të rishikuara të korrikut 2014.

6. “Personat e zhvendosur” janë personat që, për llogari të zbatimit të projektit, do të pësonin ndikime të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale që rezultojnë në: a) marrjen e pavullnetshme të tokës, që rezulton në: i) zhvendosje ose humbjen e strehës; ii) humbjen e sendeve pasurore ose aksesin të sendet pasurore; dhe iii) humbjen e të burimeve të të ardhurave ose mjeteve të jetesës, pavarësisht nëse personat e cenuar duhet të transferohen; ose b) kufizimin e pavullnetshëm të aksesit të zonat e destinuara ligjërisht ose zonat e mbrojtura që rezultojnë në ndikime negative për jetesën e këtyre personave.

7. “Vlerësim i ndikimit mjedisor dhe social” ose “VNMS” do të thotë, në lidhje me çdo aktivitet sipas pjesëve 2 dhe 3 të Projektit sipas së cilës KMMS-ja kërkon një vlerësim të ndikimit mjedisor dhe social, ku ky vlerësim kryhet në këtë Marrëveshje, në pajtim me KMMS-në; dhe “VNMS-të” që do të thotë më shumë se një VNMS.

8. “Kuatridhë i menaxhimit mjedisor dhe social” ose “KMMS” është kuatridhë mjedisor dhe social i përgatitur nga OSHEE-ja dhe që është bërë publike në faqen e OSHEE-së më 23 prill 2014 dhe në Infoshop-in e Bankës më 25 prill 2014, që përcakton modalitetet për kontrollin dhe procedurat mjedisore për prezantimin dhe zbatimin e vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe social dhe planet e menaxhimit mjedisor dhe/ose sociale sipas pjesëve 2 dhe 3 të Projektit dhe këto terma përfshijnë të gjithë grafikët dhe anekset e KMMS-së.

9. “Plani i menaxhimit mjedisor dhe social” ose “PMMS”-ja do të thotë, në lidhje me çdo aktivitet sipas pjesës 2 të Projektit në përputhje me të cilin KMMS-ja dhe VNMS-në e këtij aktiviteti



të përmendur një plan menaxhimi mjedisor dhe social, dhe ky plan përgatitet në përputhje me KMMS-në dhe VNMS-në në përputhje me dispozitat e seksionit I.D të pjesës së 2-të të kësaj marrëveshjeje dhe “PMMS-të” do të thotë se janë më shumë se një PMMS.

10. “Kushte të përgjithshme” janë “Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Huat” të datës 12 mars 2012.

11. “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” ose “KESH” do të thotë një shoqëri për prodhimin e energjisë, e themeluar dhe që operon në bazë të ligjit mbi themelimin e Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, të datës 10 tetor 1995, ose pasuesi i saj ligjor.

12. “KSHE-të e KESH/ OSHEE” do të thotë kontrata e shërbimit të energjisë ndërmjet KESH-it dhe OSHEE-së të përmendur në seksionin I.B.3 (a) (i) të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

13. “KSHE-të e KESH/ OST” do të thotë kontrata e shërbimit të energjisë ndërmjet KESH-it dhe OST-së të përmendur në seksionin I.B.3 (a) (ii) të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

14. “LEK” është monedha lokale e Huamarrësit.

15. “Konsumatorë të tensionit të mesëm” janë konsumatorët e lidhur më rrjetin e shpërndarjes 35/20/10/6 kV.

16. “MEI” është Ministria e Energjetikës dhe Industrisë së Huamarrësit ose pasuesi i saj ligjor;

17. “Kosto operative” janë kostot shtesë operative që bëhen për llogari të zbatimit, menaxhimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së Projektit (ku këto shpenzime janë parashikuar në buxhetin vjetor të NJMP-së), duke përfshirë furnizimet e zyrës, mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës, tarifat e programeve të licencave të përdoruesit, komunikimin, shërbimet e brendshme operimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pagat e personelit të NJMP-së (duke përjashtuar pagën e punonjësve të shërbimit civil të Huamarrësit).

18. “Operatori i Sistemit të Transmetimit” ose “OST” do të thotë një shoqëri aksionere e transmetimit të energjisë, e ngritur dhe që operon në përputhje me ligjin mbi themelimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit JSC të datës 12 prill 2003 ose pasuesi i tij ligjor.

19. “OSHEE” ose “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” do të thotë një shoqëri aksionere e shpërndarjes së energjisë dhe pasuesi ligjor i CEZ-it.

20. “Programi i Menaxhimit të Performancës të OSHEE-së” do të thotë një plan veprimi që përbëhet nga një grup masash të ndërmarra nga MEI dhe OSHEE-ja, me synim përmirësimin e punës së OSHEE-së dhe si bazë për një kontratë që bazohet në rezultatet e menaxhimit të OSHEE-së.

21. “KSHE-ja e OSHEE/OST” do të thotë kontrata e shërbimit të energjisë ndërmjet OSHEE-së dhe OST-së të përmendur në seksionin I.B.2 (a) (iii) të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

22. “Plan Rikuperimi financiar i Sektorit të Energjisë” do të thotë plani që duhet të përgatitet dhe aprovohet nga Këshilli i Ministrave, i cili përcakton veprimet që kërkohen, ndërmjet të tjerash, për të përmirësuar eficiencën, ulur humbjet, përmirësuar mbledhjen e parave, dhe mbuluar deficitet e pafinancuara, me qëllim që sektori i energjisë të bëhet një sistem i vetë-financuar.

23. “Kontratë e Shërbimit të Energjisë” ose “KSHE” është KSHE-ja midis OSHEE/OST, KSHE-ja midis KESH/OSHEE dhe KSHE-ja midis KESH/OST të përmendur në Seksionin I.B.3 të Pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

24. “Udhëzime të prokurimit” janë “Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve të jokonsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore” të janarit 2011 dhe të rishikuara të korrikut 2014.

25. “Plani i prokurimit” është plani i prokurimit të Huamarrësit për Projektin, i datës 1 gusht 2014 dhe i përmendur në paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve të konsulentit, i cili do të përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e këtyre paragrafëve.



26. “Subjekte të zbatimit të projektit” janë KESH-i, OSHEE-ja, dhe OST-ja, dhe subjekti i zbatimit të Projektit është një prej tyre.

27. “Legjislacioni i subjekteve të zbatimit të projektit” do të thotë: i gjithë legjislacioni përkatës në lidhje me themelimin dhe veprimtarinë e subjekteve të zbatimit të projektit duke përfshirë ligjet, mbi: a) Themelimin e Korporata Elektroenergetike Shqiptare të datës 10 tetor 1995; b) Themelimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të datës 12 prill 2003; c) Themelimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të datës 8 qershor 2007.

28. “Njësi të Zbatimit të Projektit” do të thotë njësitë që do të ngrihen brenda çdo Njësie të Zbatimit të Projektit në përputhje të një urdhri të nxjerrë nga MEI dhe që përmendet në seksionin 1.A.2 të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

29. “Njësi e Menaxhimit të Projektit” do të thotë një njësi që do të ngrihet brenda MEI-t në vijim të një urdhri të nxjerrë nga MEI, duke përfshirë personelin kryesor që duhet të rekrutohet për Projektin dhe që përmendet në seksionin I.A.1 të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

30. “Manual i funksionimit të projektit” do të thotë një manual i përgatitur në pajtim me seksionin 1.B.1 të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje dhe i konfirmohet dhe i pranueshëm për bankën dhe i miratuar nga huamarrësi, duke përkrahur dhe përcaktuar procedurat për zbatimin e Projektit dhe masat institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme duke përfshirë, ndër të tjera, grafikët e veprimeve që kërkohen për zbatimin e Projektit, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të Njësive të Zbatimit të Projektit dhe MEI-t në zbatimin e Projektit.

31. “Plan i veprimit të risistemimit” ose PVR” do të thotë, për çdo aktivitet të Projektit sipas pjesëve 2 dhe 3 të Projektit që lidhen me personat e zhvendosur, një plan veprimi risistemimi për këtë aktivitet të përgatitur dhe zbatuar në pajtim me KPR-në sipas dispozitave të seksionit I.D të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

32. “Kuangër i politikës së risistemimit” ose “KPR” do të thotë kuadri i Huamarrësit i datës dhe publikuar më 24 prill 2014, duke përcaktuar modalitetet për transferimin dhe kompensimin e personave të zhvendosur sipas pjesëve 2 dhe 3 të Projektit.

33. “Llogari e të ardhurave të bllokuara për garanci” do të thotë llogaria e përmendur në seksionin IV.B.1 të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje.

34. “Strategjia e menaxhimit të riskut” do të thotë një studim i kryer nga Huamarrësi sipas pjesës 4(d) të Projektit për qëllimet e zbutjes së paqëndrueshmërisë së motit dhe ndikimit të tij në sektorin e energjisë.

35. “Kuangër i masave mbrojtëse” do të thotë është KMMS-ja ose KPR-ja, sipas kontekstit; dhe “Kuangërot e sigurive” janë së bashku këto dy kuadro.

36. “Instrumentet e masave mbrojtëse” do të thotë VNMS, PMMS-ja ose një PVR për një aktivitet Projekti sipas pjesëve 2 dhe 3 të Projektit, sipas kontekstit dhe “Instrumente sigurie” së bashku janë të gjithë këto vlerësime ose plane për pjesët 2 dhe 3 të Projektit.

37. “Marrëveshje dytësore e huas” do të thotë marrëveshja e përmendur në seksionin I.B.2 të pjesës së 2-të të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me të cilën Huamarrësi u ofron pjesë të shumave të Huas subjekteve përkatëse të zbatimit të Projektit.

38. “Qendër e të dhënave të matjes së transmetimit” do të thotë struktura përgjegjëse për përfundimin e të dhënave, matjen për Konsumatorët me voltazh të mesëm, ushqyesit dhe prodhuesit e pavarur të energjisë.



39. “Trajnim” do të thotë të gjitha kostot e arsyeshme në lidhje me trajnimin, seminarët dhe vizitat studimore lokale dhe ndërkombëtare për personelin e përfshirë në aktivitetet e Projektit, që specifikohen në planin vjetor të punës dhe buxhetin, duke përfshirë kostot e lidhura me udhëtimin, akomodimin, që mbështesin trajnimin, seminarët dhe turet studimore të pjesëmarrësve, kostot në lidhje me sigurimin e shërbimeve të trajnerëve, marrjen me qira të mjediseve të trajnimit dhe seminareve, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe seminareve, si dhe shpenzimeve të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zbatimin e kurseve të trajnimit, seminareve ose tureve studimore.